



for4U fYou

KFOR
KOP



Shkolla e muajit



**Këndi sportiv:
FORCA "DARDANËT"!**



**Fashion: Khinset e
shqyera janë 'COOL'!**

Falas

**Music Box:
ANA KABASHI**

Revistë mujore e KFOR-it • Nr.157 • Maj 2019



MOVIEMANIA:





Kopertina:
ANA KABASHI

“For You” është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financuar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përmbytja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet emri i shkrimtarit të mos tregohet, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

Kryeredaktore:

Leonora Shabanaj
Nikshiq

Gazetarë: Ali Rexha,
Violeta Matovic

Fotografitë: Ekipi “4U”

Design & Layout:
Bekim Shabani

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon:

038/503-603-2139

Letrat mund të dërgohen në adresën:

HQ KFOR - Kosova
Film; Revista “For You”;
Strasbourg Building;
10000 Prishtinë

E-mail: magazineforyou2003@gmail.com;

<http://www.magazineforyou.com>

EDITORIAL

Përsëritje lexues të dashur!

Ne po takohemi përsëri në këto ditë të ngrohta maji. Besoj se edhe ju jeni duke kaluar mirë dhe se jeni duke punuar me vullnet që të përfundoni me sukses edhe një vit shkollor. Së pari dua t’ju falënderoj për letrat që ju po na i dërgoni, mbes me shpresë se ia kemi arritur që të iu plotësojmë disa nga dëshirat tuaja. Ne jemi këtu për ju andaj dëshirat dhe kërkesat tuaja janë prioritet për ne. Por, të mos e zgjas më shumë. Si gjithmonë jemi munduar që para jush të sjellim shumë gjëra interesante: lajme të reja nga bota e muzikës, filmit, teknologjisë moderne. Shkojmë me rend: Në këndin e shkollës së muajit, kësaj here do zë vend shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Skënder Kastrati” në fshatin Malësi e vogël (Radoste), komuna e Rahovecit. Për adhuruesit e faqes së modës, paraqesim disa modele shumë interesante dhe në trend të xhinseve.

Vazhdojmë më tutje me Ana Kabashin, ku para jush Ana rrëfen shumë detaje nga jeta e saj, të cilat jam e sigurtë se nuk i keni ditur më parë. Në Mbretërinë e Kafshëve, do të mësoni se cilat janë mamatë më fantastike të kafshëve kurse në faqen e teknologjisë para jush shpalosim aplikacionet më të mira për editimin e fotografive të cilat patjetër se do t’ju hyjnë në punë këtë verë.

Filmat më të rinj nga produksioni i huaj, Ekipi Kombëtar i Kosovës në futboll, këndi juaj janë vetëm disa nga titujt e shumtë që ju do të mund ti gjeni në vazhdim. Ndër titujt e temave sociale veçojmë: “Road to Bondsteel” dhe “Ne flasim me Ju, ne ju dëgjojmë Ju”. Por kjo nuk është e tëra, enigmatika, letrat tuaja e shumë të tjera janë duke pritur që ju ti lexoni andaj, shfletoni me kujdes revistën dhe të gjitha do ti gjeni.

Unë vetëm dua të iu përsërites edhe njëherë dhe t’ju ofroj takim të ardhshëm në muajin qershor.

Deri atëherë mirë mbetshi.

Leonora

INDEKSI

MOVIEMANIA



18



19

MUSIC BOX



10



12

ROAD TO BONDSTEEL



24

PËRSE DUA TË BËHEM OFICER POLICIE?

2-3: Editoriali, indeksi

4-5: Shkolla e muajit: SHFMU “Skënder Kastrati”

6-7: Ne flasim me Ju, Ne ju dëgjojmë Ju

8-9: Fashion: “S’po kupton mam, xhinset e shqyera janë ‘cool’!”

10-11: Music Box: Ana Kabashi

12-13: “Road to Bondsteel”

14-15: Mbretëria e kafshëve: Nëna të mrekullueshme nga bota e kafshëve

16-17: Poster: Kombëtarja e Kosovës në Futboll

18-19: Moviemania:

The Public; The Avengers: endgame; Ploey; Long shot

20-21: Këndi sportiv: Forca “Dardanët”!

22-23: Hi-Tech: Aplikacionet më të mira për rregullimin e fotografive për iPhone dhe Android

24-25: Përse dua të bëhem oficer policie?

26-27: Të mos lejojmë që ndotja e ambientit të jetë trashëgimia jonë

28-29: Këndi juaj ...

30: Këndi enigmatik

31-32: Letrat e lexuesve

INDEX

16

POSTER:
Kombëtarja
e Kosovës



HI-TECH 22




SHKOLLA E MUAJIT



4

KËNDI SPORTIV



20

MBRETËRIA
E KAFSHËVE



14

2-3: Editorial,
index
4-5: School of
the month: EJHS
"Skënder Kastrati"
6-7: "We talk to you,
we listen to you"
8-9: Fashion: "But
you don't understand,
mum, ripped jeans
are cool."
10-11: Music Box:
Ana Kabashi
12-13: "Road to
Bondsteel"
14-15: Animal
Kingdom: Remark-
able animal moms
16-17: Poster:
Kosovo National
Football team
18-19: Moviemania:

The Public; The
avengers: endgame;
Ploey; Long shot
20-21: Sports
corner: Go, go
"Dardanët!"
22-23: Hi-Tech:
Best photo editing
apps for iPhone and
Android
24-25: Why do I
want to be a police
officer?
26-27: Lets' not
allow environment
pollution be our
legacy
28-29: Your
corner ...
30: Puzzle
31-32: Reader's
letters

EDITORIAL

Greetings dear readers,

We are meeting again in these warm days of May. I believe that you are also having a good time and working with great volition to successfully complete another school year. Firstly, I would like to thank you for the letters you are sending to us, and I remain hopeful that we have achieved to fulfill some of your wishes. We are here for you, therefore your wishes and requests are a priority to us. However, let's move on. We have always tried to present to you many interesting topics such as: latest news from the world of music, film, modern technology. Let's go by order: In the School of the Month Corner, this time we will feature the Primary and Lower Secondary School "Skender Kastrati" in the village of Malësi e vogël (Radoste), Municipality of Rahovec. For the admirers of the Fashion page, we present some very interesting and trendy jeans models.

We go on with Ana Kabashi, where Ana tells us many details from her life, which I am sure you have not known before. In the Animal Kingdom, you will learn about the most fantastic animal moms, while in the Hi-Tech page we have revealed the best applications for photo editing, which will indeed be of great use this summer.

The latest Movies from foreign production, the Kosovo National Football Team, Your Corner are only some of many titles that you may further find in this edition. Among the social topic titles we would like to distinguish the following: "The Road to Bondsteel" and "We talk to you, we listen to you." However, this is not all, Enigma, Your Letters and many other columns are waiting to be read by you, therefore carefully go through our magazine and you will find everything there.

I would like to send my regards to you once again, and invite you to our next meeting in June.

Until then, best regards,

Leonora



Cover:
ANA KABASHI

'For You' is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely. The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

Chief Editor:

Leonora Shabanaj Niksic

Journalists:

Ali Rexha, Violeta Matovic

Photos by: "4U" team

Design & Layout:
Bekim Shabani

The editorial staff can be contacted on:
038/503-603-2139

Any letters can be sent at:

HQ KFOR - Film City;
For You magazine;
Strasbourg building;
10000 Pristina;
E-mail: magazineforyou2003@gmail.com;
<http://www.magazineforyou.com>

SHFMU "SKËNDER KASTRATI"



Drejtori Leonard MORINA

Ndonëse gjendja aktuale e Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Skënder Kastrati", në fshatin Malësi e Vogël (Radoste) në Komunën e Rahovecit, nuk e jep një përshtypje të tillë, rrugëtimi i saj që nga themelimi e deri më sot nuk ka qenë aspak i lehtë.

Një shkollë e vogël me peripeci të mëdha

Ajo u themelua për herë të parë në vitin 1954 mirëpo, për shkak të rrethanave të asaj kohe shumë shpejt u mbyll për t'u rihapur sërish në vitin 1965 si paralele e ndarë e shkollës së fshatit Ratkocv. Në vitin shkollor 1970-1971 u pavarësua si shkollë e plotë fillore. Një vit më vonë u ndërtua edhe objekti i parë shkollor. Kjo ndërtesë mbeti në funksion deri në vitin shkollor 2012-2013 kur edhe u përfundua ndërtimi i shkollës së re, një ndërtesë e cila e zbukuron qendrën e këtij fshati si një gur i çmuar.



Zbatim i metodave të reja kreative ku nxënësit janë pjesëmarrës aktiv në procesin e mësimdhënies janë praktikë gjithnjë e më e zakonshme e arsimtarëve gjatë orëve të tyre të mësimin.



Ky grup i fëmijëve të SHFMU "Skënder Kastrati" ishte shumë i kënaqur që të takohej të cilët ua shpërndanë Revistën 'For You'. Ky moment u përjetësua në këtë foto nga

Përkundër problemeve puna nuk është ndalur asnjëherë

Është tejet inkurajues fakti se 98 për qind e mësimitdhënësve në këtë shkollë janë të kualifikuar sipas kërkesave aktuale. "Vetëm dy prej arsimtarëve që japin mësim tek ne janë me shkollë të lartë, mirëpo që të dy ata dalin në pension brenda këtij viti. Të tjerët të gjithë i kanë të përfunduara fakultetet përkatëse, të paktën në nivelin Bachelor, dhe deri në vitin 2021 sipas kërkesave besoj se të gjithë do t'i kenë diplomat e nivelit Master," shtoi me entuziazëm drejtori Morina. Ai vazhdoi më tutje duke theksuar se një tipar tjetër pozitiv në

këtë shkollë është bashkëpunimi tejet i mirë me prindërit ndonëse, siç u shpreh ai gjithmonë ka hapësirë për përmirësim. "Duke qenë se jemi në fshat, përparësia jonë është se njihemi të gjithë mes veti dhe e kemi shumë më të lehtë që të komunikojmë me njëri-tjetrin," shtoi z. Morina.

Me hapa të sigurt drejt të ardhmes

Përkundër ndërtesës së re dhe moderne, kësaj shkolle ende i mungojnë kabinetet si dhe fushat për edukatë fizike. Lajmi i mirë është se shkolla ka hapësirë të mjaftueshme si dhe i ka fituar dy grante për furnizimin e kabineteve. Kabineti i informatikës është pajisur me disa projektorë dhe laptopë kurse, së shpejti do të furnizohet edhe kabineti për fizikë-kimi-biologji. Problem mbeten fushat për sport dhe këndi i lojërave mirëpo, drejtori Morina me shpresë shtoi: "Pas emërimit tim si drejtor e kam përgatitur një projekt për ndërtimin e dy fushave sportive dhe një këndi të lojërave. Sivjet komuna nuk ka fonde për realizimin e



Arsimtarët e mbik se nxënësit janë



tij. Shpresoj që vitin tjetër të fillojmë ta realizojmë këtë projekt të paktën pjesë-pjesë. Në anën tjetër kemi filluar që me vet kontribut ta rregullojmë oborrin e shkollës me vendosjen e disa stolave si dhe me mbjelljen e disa fidanëve të pishave, luleve, etj.”

Puna dhe angazhimi gjithmonë shpërblehen

Sipas drejtorit Morina, treguesi më i mirë për punën serioze që bëhet në këtë shkollë janë sukseset e arritura në garat e ndryshme sportive dhe ato të dijes. Ndër to ai e veçoi garën e sivjetme komunale në voleyboll ku ekipi i vajzave si dhe ekipi i djemve i zunë vendet e dyta në kategoritë përkatëse. Me fjalë të tjera, sipas sukseseve të arritura është e sigurt të thuhet se kjo shkollë bën pjesë në mesin e dhjetë shkollave më të mira në Rahovec. Në fund drejtori Morina i porositi të gjithë të rinjtë që të lexojnë më shumë dhe dijen që e akumulojnë ta zbatojnë në vendin e tyre.

me këta ushtarë të KFOR-it fotografi ynë.



Puna e pavarur në klasë është po aq e rëndësishme sa edhe detyrat e shtëpisë dhe ushtrimet në procesin e mësimnxënies.



ëqyrin vazhdimisht punën e pavarur të nxënësve për t'u siguruar duke përparuar si duhet.

EJHS “SKËNDER KASTRATI”

Although the current state of the Elementary and Junior High School “Skender Kastrati” in the village of Malësi e Vogël (Radoste) in the Municipality of Rahovec does not relay such an impression, its journey since the establishment until today hasn't been easy at all

A small school with great struggles

It was founded in 1954 but because of the circumstances of that time it was soon closed to reopen in 1965 as satellite classes of the Ratkovic village school. In 1970-1971 school year, it became a fully independent primary school. A year later, the first school building was constructed. This building remained in operation until the 2012-2013 school year when the construction of the new school was completed, a building that adorns the centre of this village as a gemstone.

Despite problems, work has never stopped

It is very encouraging that 98 percent of teachers in this school are qualified according to current requirements. “Only two of our teachers are with high school education. However both retire during this year. Others have completed the respective studies at least at Bachelor level and by 2021, according to the requirements, I believe that everyone will have acquired Master degree,” principal Morina added enthusiastically. He went on to point out that another positive feature in this school is the very good cooperation with parents, although he said there is always room for improvement. “Because we are in the

village, our advantage is that we know each other and it's very easy for us to communicate with each other,” Mr. Morina added.

Safe steps towards the future

Despite the new and modern building, this school still lacks laboratories as well as areas for physical education. The good news is that the school has enough space and has won two grants for acquiring laboratories. The IT laboratory is equipped with several projectors and laptops, and soon the physics/chemistry/biology laboratory will also be furnished. Sports and games corner still remains a problem, however, a hopeful principal Morina added: “After my appointment as Principal, I have designed a project for building two sports fields and a games corner. This year the municipality has no funds for its implementation. I hope that next year we will start implementing this project at least partially. On the other hand, with our own contribution we started to fix the school yard with the installation of several benches and planting some seedlings of pines, some flowers, etc.”

Hard work and commitment are always rewarded

According to principal Morina, the success achieved in the various sports and knowledge competitions is the best indicator of the serious work done at this school. Among them he highlighted this year's municipal volleyball competition where the girls' team as well as the boys' team won second places in the respective categories. In other words, according to the successes achieved, it is safe to say that this school is among the top ten schools in Rahovec. In the end, principal Morina urged all young people to read more and to implement the acquired knowledge in their country.

NE FLASIM ME JU, NE JU DËGJO



USHTARËT POLAK NË LEPOSAVIQ : Një ekip i ushtarëve polak në një shëtitje të shkurtër nëpër rrugët e Leposaviqit në ndërkohë që zhvillojnë një bisedë të këndshme me një nga banorët e atjeshëm.



SHPËRNDARJA E REVISTËS 'FOR YOU': Revista 'For You' gjithmonë ofron një mundësi të mirë për ushtarët e KFOR-it që të takohen dhe të bisedojnë me të rinjtë për shpresat dhe ëndrrat e tyre për të ardhmen e Kosovës.



ZËRI I FEMRAVE ËSHTË PO AQ I RËNDËS jashtëzakonisht e rëndësishme që t'i dëgjojë marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike,

JMË JU!



KOHA PËR KAFE NË LEPOSAVIQ: Branislavi (Kordinator në qendrën e rinisë në Leposaviq) e shfrytëzon mundësinë për t'i njoftuar ushtarët e KFOR-it me aktivitetet më të reja për të rinjtë në veri të Kosovës.



KOHA PËR BASKETBOLL: Pasi ndihmuan me ndërtimin e fushës sportive në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë, ushtarët e KFOR-it e shijojnë shoqërinë e të rinjve që kanë përfituar nga ky investim.



ISHËM: Për KFOR-in është të gjithë zërat në Kosovë pa gjinore apo fetare.



FUTBOLLI BASHKON: Ushtarë rumun dhe austriak iu bashkohen në një lojë futbollit vajzave dhe djemve në zonën e Rahovecit.

“S’PO KUPTON MAM, XHINSET E SHQYERA JANË ‘COOL’!

Të gjithë kemi qenë në atë fazë - keni luajtur në oborrin e shkollës, keni marrë n’thu (jemi penguar), i keni grisur copë-copë pantallonat, jeni kthyer në shtëpi me kokën ulur vetëm për t’u qortuar ashpër nga nëna me të kuptuar që i keni shkatërruar ‘të vetmet palë xhinse’ që posedoni.

“Por, mam, nuk po e kupton”, i luteni ju. “Xhinset e shqyera janë ‘cool’”. Gjë që është e vërtetë deri në një farë mase. Jo të shqyerat me ngjyrë gjaku në rrobat me palë, por të shqyerat e kujdesshme dhe të vendosura në mënyrë artistike në xhinse kanë pasur një vend në modë që nga vitet e 70-ta. Që atëherë xhinset e shqyera ose të grisura kanë hyr dhe kanë dalë nga moda vazhdimisht, por ringjallja e tyre në dekadën e fundit do të thotë se ditëve të sotme është më mirë t’i kombinoni me një pamje më të thjeshtë dhe t’i lëmë të

grisurat të bëjnë mrekullinë e vetë për ju.

Gjithashtu ia vien të mbani mend, para se t’ia shtoni pamjes suaj xhinset e grisura, që jo të gjitha pjesët e grisura janë krijuar në mënyrë të barabartë. Të gjerrat janë gërvishje të vogla në sipërfaqen e pëlhurës, afër 2.54cm në madhësi, të grrat janë aty ku pëlhura është shqyer por ka ende fije

që mbulojnë boshllëqet dhe në fund keni vrima të cilat nuk janë të mbuluara dhe mund të shihni me qartësi përmes saj. Rregulli është që të siguroheni që vrima nuk është më e gjerë se këmbët përfundi asaj të grisurës, për shkak se gjymtyrët tuaja mund të dalin nga vrima sa herë që të përkuleni. Këmbët me qime duke u përpjekur që të dalin jashtë xhinseve nuk janë një pamje e mrekullueshme. Për të mbajtur një veshje me xhinse të grisura sa më me stil dhe pedant mos zgjidhni më shumë se dy e gjysmë të grisura (një e gjerrë llogaritet si një e gjysmë), sepse nëse e tejkaloni këtë, atëherë kjo mund të jetë shpërgëndruese.

Meqë u qartësua, më poshtë mund të gjeni disa shembuj të veshjeve me xhinse të grisura për t’i veshur.

Me një xhakëtë lëkure

Lëkura dhe xhinset e grisura kanë qenë një kombinim modern që nga koha kur Ramones krijoi uniformën e punkut më me klas dhe cilësi duke kombinuar lleviskat 501 të grisura me një xhakëtë të ngushtë lëkure qysh nga mesi i viteve të 70-ta.

Çelësi qëndron tek kontrasti, andaj nëse ju zgjidhni të visheni me xhinse të ngushta, atëherë duhet të zgjidhni një xhakëtë më të lirshme dhe anasjelltas nëse zgjidhni xhinse më të gjera. Nëse lëkura ka një pamje si të vjetër dhe ndjesi të qëmotshme, atëherë zgjedhni xhinse që kanë vetëm dy të grisura për t’a bërë veshjen tuaj të duket më me stil dhe pedant. Përfundi xhakëtës mos e përzieni veshjen - një bluzë të bardhë me mëngë të

shkurta (maicë) do të përshtatet për mrekulli, ose edhe një bluzë klasike e ndonjë grupi muzikor, nëse vërtet dëshironi t’a kompletioni veshjen tuaj.

Me një xhakëtë piloti

Kur moti jashtë është i ftohtë dhe motoçikleta e juaj me siguri do t’ju përvëlojë për së gjalli, ekziston gjithmonë xhaketa e besueshme e pilotit, një veshje ikonike e burrave që ka qëndruar si një stil kyç i xhaketave në gardërobën e çdo mashkulli që nga vitet e 20-ta, kur është përdorur nga pilotët ushtarakë. Megjithatë, në vitet e fundit, ajo me të vërtetë bëri një bum, duke tejkaluar përdorimin masiv të mëparshëm. Versionet minimaliste dhe pedante janë më të lehta për t’i përshtatur sesa opsionet me theksuese, meqë kanë thjeshtësinë që përshtatet mirë me xhinset e grisura e që janë më të ndërlikuara. Nëse zgjidhni opsionin më të theksueshëm prej sateni ashtu si aktori Gosling, atëherë zgjidhni një me nuancë neutrale të errët - e zeza, e gjelbra dhe e përhimëta përshtaten mirë.

Me një këmishë

Xhinset e grisura janë zgjedhje e mirë për një pamje të zakonshme, por nëse i kombinoni ato me një këmishë, atëherë veshja juaj do të fillojë të duket me stil dhe pedante. Një këmishë klasike me pulla është një armë me dhunti të shumta për ta pasur në arsenalin tuaj të rrobave për meshkuj dhe mund të funksionojë si një zbutës i mirë i xhinseve të ashpra. Zgjidhni një ngjyrë të guximshme për këmishën në mënyrë që

pjesa e poshtme të duket bukur dhe nëse dëshironi ta mbani veshjen me stil dhe pedant mbani mend rregullin prej dy e gjysmë të grisurave.

Me një xhakëtë me kapuç

Asgjë nuk i jep theks më ta madh ‘rebelit adoleshent’ sesa një xhakëtë me kapuç dhe xhinse të grisura, edhe pse xhaketa me kapuç ka përparuar mjaft gjatë pesë viteve të fundit. Nëse dëshironi të dukeni të zgjuar dhe luksoz me xhakëtën tuaj me patent më së miri është t’a kombinoni atë me xhinse të grisura që ju parapëlqeni. Edhe xhaketat me kapuç më për trupi, për nga definicioni, rrinë në trup në mënyrë që ju të dukeni si një qese mbeturinash nëse e përshtatni atë me një palë xhinse të gjera. Andaj shumë më mirë është të zgjidhni një palë xhinse të ngushta ose të drejta.

Me një bluzë me mëngë të shkurta

Thoni lamtumirë kombinimit gërhitës e mërzitës të bluzës me mëngë të shkurta (maicës) dhe xhinseve, duke ia dhënë veshjes suaj një pamje të re, po e keni qëlluar, me një palë xhinse të grisura. Nuk ka më të thjeshtë se një bluzë të bardhë me mëngë të shkurta. Të grisurat janë mjaftueshëm të dallueshme edhe vetë, kështu që vërtet nuk duhet të zgjidhni shumë të dallueshme me llogo ose dezene.

Me katrorë

Ekzistojnë dy anë të kësaj veshjeje - xhinset më të ngushta janë më shumë një stil ‘rock and roll’, gjersa ato më të gjera kanë një pamje më të ashpër dhe të një sharrëxhiu në kombinim me një bluzë me mëngë të shkurtra. Vishni një fanellë përmbi një bluzë të zakonshme me mëngë të shkurtra por ngjyrë tjetër dhe disa atlete klasike (stili i patinatorit si allstarka janë më të mirat) për të kompletuar veshjen tuaj.



5



3

“BUT YOU DON’T UNDERSTAND, MUM, RIPPED JEANS ARE COOL.”

We’ve all been there - you’ve been playing in the school playground, tripped, tore your trousers to smithereens, went home with your head down only to get fiercely rebuked by your mother when she found out you ruined your ‘only pair’. “But you don’t understand, mum,” you plead, “ripped jeans are cool.” Which is true to some extent. Not the blood-stained tears on your nylon pleats, but carefully, artistically placed rips in denim have had a place in fashion since the 1970s. Ripped jeans dipped in and out of fashion in the years since but a

revival this decade means that nowadays it is better to pair it with a plainer look and just let the rips do the rock and roll warbling for you.

It’s also worth remembering before adding ripped jeans to your look that not all rips are created equal. Scrapes are little scratches on the fabric surface barely an inch in size, shreds are where the fabric has been torn but there are still threads covering the gaps and finally you get holes which you can clearly see through. The rule of thumb is to make sure the hole is not wider than the leg underneath as this will push your limbs out of the hole whenever you bend. Hairy legs trying to clamber out of their denim chamber is not a great look. To keep a ripped jeans outfit smart don’t go for more than two and a half rips (a scrape counts as a half) as going over can be distracting.

So, with all that cleared up, here are some simple ripped jeans outfits to style yourself.

With A Leather Jacket

Leather and ripped denim has been the go-to pairing ever since

The Ramones created the quintessential punk uniform with their ripped up Levi’s 501s worn with shoulder squeezing leather jackets way back in the mid-1970s. The key is contrast so if you’re going tight with the jeans go for a looser fit on the jacket and vice versa for a wider leg. If the leather has a beat-up, vintage feel to it, look for jeans that only have two rips to smarten it up. Don’t mess the look around underneath the jacket – a plain

white tee will work admirably, or even a vintage band shirt if you want to pay true homage.

With A Bomber Jacket

When the weather outside is sizzling and your biker will surely cook you alive, there is always the trusty bomber jacket, an iconic menswear piece that has stood as a key jacket style in every man’s wardrobe since the 1920s when it was used by military pilots. However, in recent years, it has really taken off, surpassing its previous sky-scraping heights. Minimalist, sleek versions are easier

to style than more statement options with the simplicity working well with the ripped jeans more complex edge. If you do go for a statement satin option a la Gosling, pick one in a dark neutral – black, green and grey work well.

With A Shirt

Wearing ripped jeans will always make for a casual look but pair them with a shirt and things start to look smarter. An Oxford button-down shirt is a versatile weapon to have in your menswear arsenal and can work as a solid foil to the jeans’ edginess. Choose a bold colour up top to get the bottom rocking and remember the two-and-a-half-rip rule if you want to keep it smart.

With A Hoodie

Nothing moans ‘teenage rebel’ like a hoodie and ripped jeans, although the hoodie

has come a long way in the last five years. If you’re going to look sharp and luxe with your zip-up, it’s best to follow that through with your choice of ripped jeans. Even the slimmest fitting hoodies by definition sit off the body so you can look like a bin bag if you follow that silhouette down with a wide leg. It’s much better to choose a slim taper or a straight leg.

With A T-Shirt

Say RIP to the snoring, boring nice T-Shirt and jeans combo, by ripping the look a new one with yep you’ve guessed it – some ripped jeans. It doesn’t get simpler than a plain white T-shirt. The rips have enough attitudes by themselves so you don’t really to have to go too jazzy with logos or patterns.

With Plaid

There are two sides to the look – a skinnier fit in the jeans is more rock and roll while a wider leg has the rough and ready lumberjack look to a tee. Wear a flannel shirt as an overshirt with a contrasting plain tee underneath and some hardy retro sneakers (skater styles like Vans or Converse are best) to complete the look.



2



4



6

(Source: <https://www.fashionbeans.com>)

ANA KABASHI

E sinqertë, e fuqishme, joshëse... E vendosur të arrijë qëllimin e vet, por gjithmonë me dëshirë që këtë ta bëjë me talentin dhe punën e saj të palodhshme, ajo është njëra ndër këngëtares më të angazhuara në skenën tonë. Ajo e di se si të arrijë tek zemra dhe ndjenjat e publikut. Nuk i mungon guximi dhe as ambicia. E bukur nga jashtë, me shpirt muzikor, në një bisedë tejet të sinqertë për revistën tonë, Ana Kabashi, zbulon shumëçka nga jeta e saj private.

Ana, çfarë është muzika për ty dhe kush ka ndikuar më shumë në formimin tënd si artiste?

Muzika është më shumë se thjesht një profesion për mua. Është më shumë një dashuri e imja e cila më ka dhënë shumë deri tani dhe që i jam dedikuar maksimalisht. Familja ime, prindërit e mi që më kanë përkrahur gjithmonë, sidomos kur unë e përzgjedha Fakultetin e Arteve. Ata kanë qenë dhe mbasin shtysa ime kryesore sa i përket sukseseve të mia në muzikë.

Çfarë zhanri të muzikës më me dëshirë këndon?

Unë këndoj Rock 'n' Roll, stilin muzikor të Tina Turner e kam për qejfi, Janis Joplin dhe të tjerë të kësaj rryme.

Cilat janë mesazhet e këngëve tuaja?

Më së shumti i këndoj femrave

dhe fuqizimit të zërit të tyre. Po ashtu dashuria është pjesë e pandashme e këngëve të mia.

Nëse do të darkoje më tre persona të famshëm (qofshin ata personalitete të gjalla apo të vdekura), cilët janë ata?

Barack Obama, Jessie J dhe Nelson Mandela.

Cilat gjëra në jetë të bëjnë të qeshësh?

Kur ulem në tavolinën e ngrënies me vëllain tim, gjithmonë fillojnë shakatë që përfundojnë me të qeshura pafund.

Çfarë bën gjatë vikendeve?

Të dielën ia kushtoj familjes, respektivisht motrës dhe dy fëmijëve të saj të cilët i dua shumë. Mundohemi që këtë ditë ta kalojmë sa më shpesh që është e mundur jashtë në natyrë.

Çfarë shikon më me dëshirë në TV?

Zakonisht filma, seriale amerikane ku do të veçoja "Peaky Blinders" dhe "Game of Thrones".

Nëse do të dëgjoje vetëm një këngë gjatë gjithë jetës, cila do të ishte ajo?

"Wicked Game" nga Chris Isaac.

Nëse do të haje vetëm një ushqim gjatë gjithë jetës, cili do të ishte ai?

Perime dhe ëmbëlsirën suffle.

Cilin film e ke shikuar më shumë se njëherë?

"Man on fire".

Na trego një kujtim nga fëmijëria?

Kur kam qenë e vogël ne kemi jetuar së bashku me xhaxhallarët dhe kemi qenë shumë fëmijë. Kur dilnim të luanim të gjithë së bashku ka qenë ndjenja më e mirë që më kuj-



"Muzika është më shumë se thjesht një profesion për mua. Është më shumë një dashuri e imja" Ana Kabashi

tohet nga fëmijëria. Edhe sot e kësaj dite kur e vizitoj lagjen në Pejë, në të cilën jam rritur më kaplojnë ndjenja që s'mund t'ua përshkruaj.

Çfarë do të bëje nëse do të fitoje 1 milion euro?

Do ta blija një shtëpi fantastike për prindërit e mi dhe pjesën tjetër do ta investoja në ndonjë biznes.

Destinacioni i ëndrrave?

Egjipti, më duket shumë misterioz.

Nëse një ditë do të qeverisje botën, çka do të ndryshoje?

Do të luftoja për barazi në mes të njerëzve, do t'i zhdukja të gjitha dallimet në mes të njerëzve dhe do të doja që njerëzit ta duan më shumë njëri-tjetrin.

Dëshira për Llambën e Aladin?

Të bëhem pjesë e skenës muzikore ndërkombëtare.

Në cilën periudhë të historisë kisha pasur dëshirë të jetosh?

Në shekullin e 18-të.

Në cilin qytet dëshiron të jetosh?

Tiranë dhe Paris.

Çka vëren së pari kur je në bisedë me dikë?

Energjinë që një person e transmeton tek unë gjatë bisedës së parë me të.

A është dashuria vetëm fjalë?

Dashuria është zgjedhje e një personi, është ushqim i shpirtit.

Nuk mund të jetosh pa...?

Dashuri dhe ushqim.

Po të detyrohesh të bëje njërin nga këto, cilën do ta zgjidhje:

1. Të luaje rol negativ në një telenovelë;
2. Të laje një grumbull të madh të enëve apo;
3. Të hidheshe me litar mbrojtës nga një lartësi e madhe

Çfarë mendon për të rinjtë e Kosovës dhe cila është porositja e juaj për ta?

Shkolla është bazë, është shumë e rëndësishme për ju që të mbaroni shkollën, të keni një diplomë por edhe të luftoni për atë çka me të vërtetë e dëshironi.



ANA KABASHI

Sincere, strong, attractive... Determined to achieve her goal, but always willing to do so with her talent and hard work; she is one of the most engaged singers on our showbiz. She knows how to reach the heart and feelings of the audience. She does not lack courage or ambition. Beautiful from the outside, with a musical heart, in an extremely frank conversation with our magazine, Ana Kabashi reveals much of her private life.

Ana, who had the biggest impact on you becoming an artist?

Music is more than just a job for me. It's more of a love that has given me much so far and I'm devoted to it in maximum. My family, my parents who always supported me, especially when I decided to study Arts. They are and have been my main driver in my successes in music.

What music genre you mostly prefer to sing?

I sing Rock 'n' Roll; I like the music style of Tina Turner, Janis Joplin and others in this genre.

What are the messages of your songs?

I mostly sing to women, empowering their voice. Love is also an inseparable part of my songs.

If you would chose to dine with three famous people (living or dead), who that would be?

Barack Obama, Jessie J and Nelson Mandela

What makes you laugh in life?

When I sit at the dining table with my brother, jokes always

end with endless laughter.

What do you do during weekends?

I dedicate Sundays to my family, my sister and her two children, whom I love very much. We try to spend this day as often as possible outdoors in nature.

What do you like watching in TV?

Usually American movies and TV shows, where I would single out "Peaky Blinders" and "Game of Thrones".

If you would listen to only one song throughout your life, what would it be?

"Wicked Game" by Chris Isaac

If you would pick a lifetime meal, what would it be?

Vegetables and Souffle

Which movie have you watched more than once?

"Man on fire".

Share with us a memory from childhood?

When I was little we lived together with my uncles and we were many children. When



"I mostly sing to women, empowering their voice. Love is also an inseparable part of my songs." Ana Kabashi

we went out to play together, it was the best feeling I remember from childhood. Even today, when I visit the neighborhood in which I grew up, I get full of emotions I am unable to describe.

What would you do if you won 1 million euros?

I would buy a fantastic house for my parents and I would invest the rest in a business.

Destination of dreams?

Egypt, it seems very mysterious to me.

If one day you would rule the world, what would you change?

I would fight for equality between people, I would eliminate all the differences between people, and I would make people love each other more.

If you found Aladdin's lamp, what would you wish for?

Becoming part of the international music arena.

In what period of history would you want to live?

In the 18th century

In what city you want to live?

Tirana and Paris

What do you first notice when conversing with someone?

The energy that a person transmits to me during the first conversation

Is love only a word?

Love is a person's choice, it feeds the soul.

You may not live with no ...?

Love and food.

If you were forced to do any of the following, what would you pick?

1. Play a villain in telenovela
2. Wash a large pile of dishes or
3. Bungee jumping

What do you think about young Kosovans and what is your message for them?

The school is the basis, it is very important for you to finish school, hold a diploma but also fight for what you really want.



Dikur ajo ishte lexuese e rregullt e Revistës 'For You'. Sot, ajo e viziton redaksinë tonë si një këngëtare e suksesshme për t'iu drejtuar vajzave dhe djemve të rinj që janë lexues të revistës.

“ROAD TO BONDSTEEL”



Pamje nga ndeshjet e zhvilluara në sallën e sporteve në Gjilan ku u përzgjedhën katër ekipet finaliste

Për tri fundjava rresht të rinjë shqiptarë, serb, turq, rom dhe ashkalinj nga Gjilani, Kamenica, Novobërda, Fushë Kosova, Parteshi dhe Ranillugu morën pjesë në turneun e basketbollit “Road to Bondsteel (Rruga drejt Bondsteel-it)”. Dy xhirot e para u luajtën në Gjilan dhe katër ekipet më të mira e fituan të drejtën për të luajtur ndeshjen finale dhe atë për vendin e tretë dhe të katërt në kampin ushtarak “Bondsteel”. Për shumë prej këtyre të rinjve kjo ishte hera e parë që e patën rastin që të takoheshin me bashkëmohatarë nga komunitetet e tjera e lëre më të luanin në ekipe të njëjta dhe të garonin kundër njëri-tjetrit në një garë të tillë sportive.

Sporti urë lidhëse

“Vendosa që të bëhem pjesë e këtij aktiviteti pasi që e adhuroj basketbollin,” deklaroi Dijoni pesëmbëdhjetëvjeçar nga Fushë Kosova. Ai vazhdoi: “Krahas kësaj, ideja që të luaj në një turne të tillë dhe rasti për t’i matur forcat e mia me bashkëmohatarët e mi nga etnitë e ndryshme që jetojnë në Kosovë ishte vërtetë intriguese. Po ashtu, më ka pëlqyer se ky turne synonte nxitjen e bashkëpunimit në mes ne të rinjve pa marrë parasysh përkatësinë tonë etnike. Rrjedhimisht, përmes aktiviteteve të tilla sportive ne e mësojmë se ne mund t’i tejkalojmë dallimet tona.”

Pengesa e vetme gjuha

Qëndrim të ngjashëm me këtë treguan edhe Loriani dhe Violeti, që të dy nga Gjilani. Ata theksuan se arsyeja pse kishin vendosur që të merrnin pjesë në këtë turne ishte dashuria që ata e kanë për basketbollin. Fakti se ky aktivitet ishte shumë etnik nuk ishte aspak pengesë për ata. Përkundrazi, ata e vlerësuan si tipar pozitiv pasi që përmes basketbollit kishin pasur rastin që të njihen me bashkëmohatarët e tyre nga etnitë e tjera që jetojnë në Kosovë. Problemi i vetëm



Një foto e përbashkët e të katër ekipeve finaliste të turneut “Road do të jetë një kujtim tejet i veçantë për këta të rinj



Të gjithë pjesëmarrësit luftuan për çdo top për të siguruar të drejtën për të shkuar në finalen e cila u luajt në kampin “Bondsteel” në Ferizaj



Pas shumë përpjekjeve pjesëtarët e ekipit “Motor City” me krenari e ngrenë lart kupën në shenjë të triumfit të tyre.

që ata e kishin hasur ishte pamundësia për të komunikuar rrjedhshëm për shkak të dallimeve gjuhësore. “Ne komunikam në gjuhën angleze me njëri-tjetri dhe para lojës nuk kishte probleme. Sidoqoftë, gjatë lojës ne kishim vështirësi që të shpreheshim në gjuhën angleze,” të dy djemtë shtuan me dëshpërim të dukshëm.

Më shumë sport, më pak urrejtje

Aleksandri (15) nga Shillova për revistën “For You” tha se është adhures i madh i basketbollit. Ai po ashtu e shprehi kënaqësinë e tij që e ka pranuar sfida për të luajtur në ekip të njëjtë me miqtë e tij shqiptar. “Basketbolli më



to Bondsteel". Pa dyshim, një ditë në të ardhmen, ky

plotëson dhe unë i kushtoj shumë kohë të lirë. Është hera e parë që po luaj në një skuadër me bashkëmoshatarët e mi shqiptar dhe më pëlqen se si po e ndihmojmë njëri-tjetrin dhe si po luajmë bashkë si një skuadër. Do t'i porosisja të gjithë që të merren sa më shumë me sport, që të ketë sa më pak urrejtje dhe që të shoqërohemi sa më shumë me njëri-tjetrin," theksoi Aleksandri me kënaqësi.

Toleranca dhe bashkëjetesa janë të mundura

Gjatë këtij turneu u takuam edhe me z. Dushan Avramoviq, arsimtar i edukatës fizike në Gjimnazin në Kamenicë. Sipas tij gjëja më e rëndësishme është që të rinjtë të shoqërohen, sepse sporti nuk njihet kufij apo dallime në mes të njerëzve.

Organizimi me sukses i këtij aktiviteti kërkoj përkrahje nga shumë njerëz. Një prej tyre ishte edhe znj. Shpresa Hajdari, Drejtoresha për Rini, Kulturë dhe Sport në Komunën e Gjilanit. Gjatë bisedës sonë me të ishte e dukshme se ndjenjat dhe emocionet pozitive që këta djelmoshë të ri i treguan në fushën e basketbollit ishin përçarur edhe tek ajo. "Ne e lehtësuam këtë aktivitet sepse ai tregon se toleranca dhe bashkëjetesa janë të mundura dhe ekzistojnë në Kosovë," shtoi znj. Hajdari me buzëqeshje.

Në fund do të donim t'i theksonim edhe njëherë fjalët e Dijonit i cili tha: "mbase gjeneratat e vjetra nuk mund ta tejkalojnë të kaluarën mirëpo, ne gjeneratat e reja pa dyshim që mund të hedhim hapa drejt pajtimit dhe tolerancës. Aktivitetet e tilla janë një hap në drejtimin e duhur."

Fitues i këtij turneu doli ekipi "Motor City". Gjatë tërë turneut krahas lojës individuale pjesëtarët e këtij ekipi u dalluan edhe për lojën e shkëlqyer ekipore. Në fund ishte pikërisht ky bashkëpunim që ua solli këtyre të rinjve titullin kampion.

Na vizitoni në:
Visit us at:



"ROAD TO BONDSTEEL"

Three weekends in a row young Albanians, Serbs, Turks, Roma and Ashkali from Gjilan, Kamenica, Novobrd, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Partesh and Ranilug participated in the basketball tournament "Road to Bondsteel". The first two rounds were played in Gjilan. The four best teams earned the right to play for the Championship, third place and fourth place at the military camp "Bondsteel". For many of these youngsters this was the first time they have met their peers from other communities. In addition, they had the chance to play in mixed teams and compete against each other.

Sport - a connecting bridge

"I decided to become part of this activity because I love basketball" fifteen year old participant Dijon from Fushë Kosova/Kosovo Polje stated. He continued "In addition, the idea to play in such a tournament and the opportunity to compare myself with my peers from various ethnicities that live in Kosovo was really intriguing. I also liked that this tournament aimed to stimulate cooperation between us young people, regardless of our ethnicity. Consequently, when united through sports, we learn that we may overcome our differences."

Language is the only obstacle

Lorian and Viol, both from Gjilan, expressed a similar attitude. They highlighted that the reason they decided to participate in the tournament was their love for basketball. The fact that it was multi-ethnic was not a problem at all for any of them. On the contrary, they saw it as a positive feature because through basketball they got the opportunity to meet their peers from other ethnicities that live in Kosovo. The only problem they encountered was their inability to communicate freely because of the different languages. "We used English to communicate with each other and that worked before the games. During the games, we had however some difficulties expressing ourselves in English" the two boys added with visible disappointment.

More sports, less hatred

Aleksandar (15) from Shilovo told "For You" Magazine that he is a huge fan of basketball. He also expressed his satisfaction accepting the challenge of playing on the same team with Albanian friends. "Basketball fulfills me and I dedicate a lot of my free time to playing. It is the first time I am playing on a team with my Albanian peers and I like how we are helping each other and playing like a team. I would appeal to all to do more sports so that there is less hate. We can hang out more with each other" stated a delighted Aleksandar.

Tolerance and living together is possible

During this tournament we also met Mr Dushan Avramoviq, Physical Education teacher at the Kamenica Gymnasium (high school). According to him, the most important thing is the young get to hang out with each other because sports doesn't recognize any borders or differences between people.

The successful organization of this activity required the support of many people. One of them was Ms Shpresa Hajdari, Director for Youth, Culture and Sports in the Gjilani Municipality. While we spoke to her, it was visible that the young boys positive feelings and emotions shown on the basketball court had rubbed off on her. "We facilitated this activity because it shows that tolerance and living together are possible and exist in Kosovo" a very satisfied Ms Hajdari added with a smile

In the end we would like to quote Dion once more who said "Maybe older generations cannot overcome the past. But we, the younger generations can certainly take steps towards reconciliation and tolerance. Activities like this are a step in the right direction."

The winner of the competition was the "Motor City" team. During the entire tournament, besides excellent individual performances, players showed the best team work. In the end, cooperation made these youngsters champions.

NËNA TË MREKULLUESHME NGA BOTA E KAFSHËVE

Bota e kafshëve është e mbushur me prindër të jashtëzakonshëm

Është e rëndësishme të mbani mend se njerëzit nuk janë të vetmit që

ndërmarrin hapa të jashtëzakonshëm për të mbrojtur, ushqyer dhe rritur të vegjlit e tyre. Mbretëria e kafshëve është e begatshme me nëna që kalojnë kohën për të mësuar të vegjlit e tyre se si të gjejnë ushqim dhe t'a mbrojnë veten kundër faktorëve natyrorë. Më poshtë mund të gjeni disa prej nënave shtazë të mrekullueshme që bëjnë çmos për të vegjlit e tyre:

Orangutangu

Lidhja në mes të një nëne orangutangësh dhe të vegjëlve të saj është një nga lidhjet më të forta në natyrë. Gjatë dy viteve të para të jetës, të vegjlit mbështeten tërësisht tek nënat e tyre për ushqim dhe transport. Nënat qëndrojnë me të vegjlit e tyre për gjashtë deri në shtatë vjet, duke u mësuar atyre se ku mund të gjejnë ushqim, çfarë dhe si të hahet dhe teknikën për ndërtimin e një foleje gjumi. Orangutangët femra janë të njohura për "vizitën" që ia bëjnë nënave të tyre derisa ato të arrijnë moshën 15 ose 16 vjeç.



Orangutan

The bond between an orangutan mother and her young is one of the strongest in nature. During the first two years of life, the young rely entirely on their mothers for both food and transportation. The moms stay with their young for six to seven years, teaching them where to find food, what and how to eat and the technique for building a sleeping nest. Female orangutans are known to "visit" their mothers until they reach the age of 15 or 16.



Ariu polar

Nënat e kujdeshme të ariut polar zakonisht pjellin këlysh binjakë që rrinë afër saj për rreth dy vite për të mësuar aftësitë e nevojshme të mbijetesës për klimë të ftohtë. Nëna e krijon strofullën duke gërmuar në pìrgun e thellë të borës dhe duke krijuar kështu një hapësirë të mbrojtur nga faktorë të ndryshëm. Ato zakonisht pjellin në mes të muajit nëntor dhe janar dhe përmes ngrohtësisë së tyre trupore dhe qumështit i mbajnë këlyshët e ngrohtë dhe të shëndetshëm. Këlyshët largohen nga strofulla në muajin mars dhe prill për t'u mësuar me temperatura të ambientit të jashtëm para se të mësojnë të gjuajnë.

Polar Bear

Attentive polar bear mothers usually give birth to twin cubs that stick by her for about two years to learn the necessary survival skills in the cold climate. The mothers den by digging into deep snow drifts, creating a space protected from the elements. They usually give birth between November and January and keep the cubs warm and healthy using their body heat and milk. The cubs leave the den in March and April to get used to outside temperatures before learning to hunt.

REMARKABLE ANIMAL MOMS

The animal kingdom is flush with extraordinary parents

It's important to remember humans aren't the only ones who take extraordinary steps to protect, nurture and raise their young. The animal kingdom is flush with moms that take the time to teach their babies how to find food and protect themselves against the elements. Here's a look at some outstanding animal mothers going the extra mile for their young:

Elefanti afrikan

Kur bëhet fjalë për elefantët afrikanë, atëherë një nënë e re nuk i udhëzon e vetme të vegjlit e saj. Elefantët jetojnë në një shoqëri matriarkale, kështu që femrat e tjera në grupin shoqëror i ndihmojnë të voglit të ngrihet në këmbë pas lindjes dhe i tregojnë se si të ushqehet. Elefantët e vjetër e përshtatin ritmin e tufës në mënyrë që elefanti i vogël të mund të ecë në hap me të tjerët. Duke i shikuar të rriturit, elefanti i vogël mëson se cilat bimë duhet t'i hajë dhe si të arrijë deri tek ato. Femrat rregullisht kontaktojnë me shumë dashuri me elefantin e vogël.



African Elephant

When it comes to African elephants, a new mom is not alone in guiding her young. Elephants live in a matriarchal society, so other females in the social group help a calf to its feet after birth and show the baby how to nurse. The older elephants adjust the pace of the herd so the calf can keep stride. By watching the adults, the calf learns which plants to eat and how to access them. The females regularly make affectionate contact with the calf.



Çita

Nënat e majmunëve çita i rrisin të rinjtë e tyre në izolim. Ato e lëvizin pjellën e tyre - zakonisht dy deri gjashtë këlysh - çdo katër ditë për të parandaluar një akumulim të erës, që grabitësit mund t'a nuhasin. Pas 18 muajve të trajnimit si gjahtarë, këlyshët e çitës më në fund largohen nga nënat e tyre. Më pas këlyshët formojnë një grup të vëllezërve dhe motrave dhe ky grup qëndron së bashku për gjashtë muaj të tjerë.

Cheetah

Cheetah mothers raise their young in isolation. They move their litter - usually two to six cubs - every four days to prevent a build-up of smell that predators can track. After 18 months of training as hunters, the cheetah cubs finally leave their mothers. The cubs then form a sibling group that will stay together for another six months.



Pinguini perandorak

Pasi që lëshojnë një vezë, pinguini perandorak nënë e lë atë me një mashkull që mbron vezën e brishtë dhe të fortë nga faktorët e tjerë natyrorë. Nëna pastaj udhëton deri në 50 milje për të arritur në oqean dhe peshk. Më pas, ajo kthehet në vendin ku veza do të çelë, për të zbratur ushqimin nga stomaku i saj tek zogu i sapoçelur. Duke përdorur ngrohtësinë e qeses së saj të zogut, nëna e mban zogun të ngrohtë dhe të sigurt.

Emperor Penguin

After laying an egg, the mother emperor penguin leaves it with a male who protects the fragile hard shell from the elements. The mother then travels up to 50 miles to reach the ocean and fish. She later returns to the hatching site to regurgitate the food to the newly hatched chicks. Using the warmth of her own brood pouch, the mother keeps the chick warm and safe.

for4U
fYou



KOMBËTARJA E KOSOVËS



© Shpend Ahmeti

AVENGERS

INFINITY WAR

PART I PART II
MAY 2018 MAY 2019

THE AVENGERS: ENDGAME

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Benedict Cumberbatch
Regjia: Anthony Russo & Joe Russo
Skenari: Christopher Markus & Stephen McFeely

Përmbajtja

The Avengers (Hakmarrësit) kanë triumfuar mbi Lokin dhe ata do të përballen me Ultronin, por asgjë nuk mund t'i përgatisë ata për kërcënimin që vjen nga Thanosi.



THE AVENGERS: ENDGAME

Cast: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Benedict Cumberbatch
Director: Anthony Russo & Joe Russo
Scenario: Christopher Markus & Stephen McFeely

Synopsis

The Avengers have triumphed over Loki, and they'll face Ultron...but nothing could prepare them for the menace of Thanos.



PLOEY

PLOEY

Rolet: John Stamos, Sean Astin, Jerry Garcia
Regjia: Árni Ásgeirsson
Skenari: Árni Ásgeirsson

Përmbajtja

Kur ai ndahet nga familja e tij, Ploey, një zogth i ri këmbëgjatë jo fluturues, duhet të ndërmarrë një udhëtim të rrezikshëm drejt një lugine legjendare për të shpëtuar të dashurit e tij që të mos bien pre e skifterit të ligë.

PLOEY

Cast: John Stamos, Sean Astin, Jerry Garcia
Director: Árni Ásgeirsson
Scenario: Árni Ásgeirsson

Synopsis

When he gets separated from his family, Ploey, a young flightless plover chick, must undertake a dangerous journey to a legendary valley in order to save his loved ones from falling prey to the evil falcon.



LONGSHOT



LONG SHOT

Cast: Charlize Theron, Seth Rogen, Alexander Skarsgard, June Diane Raphael, Andy Serkis, Randall Park
Director: Dan Sterling
Scenario: Dan Sterling

Synopsis

Fred Flarsky is a gifted and free-spirited journalist with an affinity for trouble. Charlotte Field is one of the most influential women in the world. Smart, sophisticated, and accomplished, she's a powerhouse diplomat with a talent for...well, mostly everything. The two have nothing in common, except

